

Nr. 15/1 Prot
25.04.2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

VENDIM

Nr. 10 datë 25/04 2017

Për miratimin e lejes “ Për rehabilitimin e shtratit të lumit të Rapunit ”, degë e lumit Shkumbin, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, subjektit “Disha / LBND” shpk”.

Në zbatim të ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 5 pika 2, neni 12 pika 2, neni 50 pika 2, neni 65 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 416 datë, 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posacme, dokumentave shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, me Nr. 309, datë 31.05.2016, për “Ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Identifikimin e Nevojave për Rehabilitimin e Shtretërve të Lumenjve”, bazuar në shkresën Nr.9706 Prot, date 16.12.2016 të Ministrit të Bujqësisë ku dërgohet lista e segmenteve të miratuara për rehabilitimin e shtratit të lumit Shkumbin, Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 5 datë, 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr 6. datë 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin

VENDOSI:

Për miratimin e lejes “ Për rehabilitimin e shtratit të lumit të Rapunit ”, degë e lumit Shkumbin, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, subjektit “Disha / LBND” shpk”.

Specifikimet e zonës për rehabilitim :

Koordinatat :

X	44 41 058	Y	45 64 896
X	44 41 564	Y	45 62 521

Sip. e rehabilitimit

0.0459 Km²

Investimi i planifikuar për mbjelljen e pemëve në nr. pemësh 1000 pemë plep, shëlg dhe akacie.

Germim zhavorri me skrepër , përgjatë shtratit të lumit.

Prurjet sipas studimit.

Prurja mesatare vjetore $Q_{mes.}$ 15.4 m³/sek

Prurja mesatare e muajit më të thatë $Q_{min.}$ 7 m³/sek

Periudha e rehabilitimit të shtratit të lumit 5 vjet.

Vendimi hyn në fuqi pas zbardhjes së tyre formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

PËRGJEGJËS ABU

SHKUMBIN

Erald SEJDINI



KRYETARI I KBU SHKUMBIN

PREFEKTI I QARKUT

ELBASAN

Arben KAMAMI

